



KRYEQYTETI YNË PRISHTINA, NIKOQIRE E KONFERENCËS SË 42-të, MYSAFIRË ISHIN DREJTORËT POLICORË TË 26 KRYEQYTETEVE EVROPIANE

Konferenca e drejtorëve të policive të kryeqyteteve evropiane, është një ngjarje vjetore që sjell së bashku krerët e Policisë të kryeqyteteve të Evropës, që prej edicionit të tij të parë, të mbajtur në vitin 1979 në qytetin e Londrës. Kosova, përkatësisht Drejtoria Rajonale e Policisë së Prishtinës nga viti 2016 ka marrë pjesë në këtë konferencë, fillimisht si vëzhguese në Budapest (Hungari), e më pas si anëtare e barabartë në vitin 2017 në Lisbonë (Portugali).

EDITORIAL

Që nga themelimi i Policisë së Kosovës përpykjet tona të vazhdueshme në bashkëpunim edhe me miqtë tanë ndërkombëtarë për formimin profesional dhe avancimin në funksion të arritjeve dhe rezultateve në fushën e zbatimit të ligjshmërisë në vend na kanë ndikuar të kemi vlerësime dhe rezultate pozitive edhe përtej kufijve tonë shtetërorë.

Policia e Kosovës shpesh është marrë si shembull për të mirë në rajon dhe më gjerë edhe nga organizata dhe personalitete të ndryshme për arritjet profesionale të zyrtarëve të saj dhe kualiteteve të larta të qasjes profesionale në garantimin e sigurisë së përgjithshme, zbatimin e ligjit, ruajtjen dhe kultivimin e barazisë, të drejtave njerëzore dhe transparencës.

Me gjithë pengesat dhe sfidat e natyrave të ndryshme për të ranguar apo anëtarësuar Policinë e Kosovës krah për krah me organizatat e sigurisë në botë, sikurse është INTERPOL-i dhe EUROPOL-i, në anën tjetër ka vazhduar krijimi i raporteve dhe bashkëpunimi me shtete dhe vende mike veç e veç, ku edhe janë krijuar rrethana dhe mundësi të bashkëpunimit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe trajtimin e rasteve të ndryshme në nivel ndërkombëtar. Operacione të suksesshme policore transnacionale janë realizuar në bashkëpunim me agjencitë dhe policitë e vendeve më të zhvilluara në botë.

Këtë vit kryeqyteti ynë Prishtina, respektivisht Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Prishtinë, si nikoqire, për herë të parë ka pritur në konferencën e 42-të drejtorët e policive të kryeqyteteve evropiane, ku kanë marrë pjesë 26 përfaqësues të vendeve të ndryshme nga Evropa.

Ky ishte një rast tjetër i shkëlqyeshëm, ku nga pjesëmarrësit dhe nikoqiri u mbajtën prezantime, si dhe u zhvilluan takime për të elaboruar dhe për të avancuar bashkëpunimin strategjik reciprok ndërmjet familjes së madhe policore evropiane.

Duke qenë se kjo konferencë është zhvilluar për herë të parë në vendin tonë, organizimi dhe përmbajtja e saj ka përmbushur dhe ka arritur të gjitha pritshmëritë e Policisë së Kosovës, por edhe të pjesëmarrësve, duke marrë parasysh edhe komentet dhe vlerësimet e larta të mysafirëve pjesëmarrës.

Ndër vite, po ashtu edhe këtë vit Policia e Kosovës me sukses ka realizuar objektivat strategjike, në interes të sigurisë dhe rendit kushtetues, duke qenë çdo herë transparente, përgjegjëse, llogaridhënëse dhe me integritet të lartë në shërbim ndaj qytetarëve dhe vendit.

**Baki KELANI****Revistë e Policisë së Kosovës****Botues:****ZIMP**

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Kryeredaktor:**Baki KELANI****Redaktor:****Daut HOXHA****IT-Dizajn - Grafikë:****Çajup KAJTAZI****Lektor:****Leonora FEJZULLAHU - RUHANI****IT-Multimedia:****Arbër MUHADRI****Bashkëpunëtorë:****Çajup KAJTAZI****Arlinda REXHEPI - GËRXXHALIU****Blerinë EUJPI****Merita CANOLLI - GASHI****Tel:****Tel.: 038 5080 1243****Tel.: 038 5080 1237****Mob.: 044 506 308****Mob.: 044 181 418****E-mail:****baki.kelani@kosovopolic.com****daut.hoxha@kosovopolic.com****zimp@kosovopolic.com****Telefon: 192****info@kosovopolic.com****www.kosovopolic.com****facebook.com/KosovoPolice**



PËRMBAJTJA

4| U. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Hoti, priti në takim komandantin e ri të KFOR-it, z. Ristuccia

4| Komandantët amerikanë të Bondsteel-it u pritën në takim zyrtar nga u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

5| Gjatë qëndrimit në Izrael u. d. drejtori z. Hoti, ka realizuar takim zyrtar me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Izraelit

5| U. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës priti në takim drejtorin e Policisë së Shtetit

6| Një delegacion nga Departamenti i Mbrojtjes për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës vizitoi Policinë e Kosovës

6| Në ambientet e Policisë së Kosovës takohen krerët e dy institucioneve

7| Policia Kufitare pranon donacion nga qeveria gjermane

8-15| Kryeqyteti ynë Prishtina, nikoqire e konferencës së 42-të, mysafirë ishin drejtorët policorë të 26 kryeqyteteve evropiane

16| Përfaqësues të zyrave për informim nga institucionet kosovare vizitojnë Holandën

17| Stafi civilë, shtyllë mbështetëse për Policinë e Kosovës

18| Heroizmi i policisë gjatë punës

19| U mbajt Takimi i 20-të i Këshillit Ekzekutiv të Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve)

20-21| Mbresat dhe krenaria gjatë trajnimit 'GRATË, PAQJA DHE SIGURIA', të mbajtur në Emiratet e Bashkuara Arabe

22-23| Operacione

24| Policia e Kosovës në fushatën 16 ditore kundër dhunës në familje

25| Udhëzuesi informues për lehtësimin e komunikimit në mes të Policisë së Kosovës dhe personave të shurdhër

26| Policia e Kosovës, e përkushtuar në ofrimin e sigurisë dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me qytetarë

27| Sindikata e Policisë së Kosovës nderon 22 heronjtë e PK-së, të cilët kanë rënë në kryerje të detyrës zyrtare



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.

U. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Hoti, priti në takim komandantin e ri të KFOR-it, z. Ristuccia

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë, u. d. drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Fehmi Hoti, priti në takim zyrtar komandantin e ri të KFOR-it, gjeneral-major Angelo Michele Ristuccia.

Gjatë këtij takimi njoftues, përveç tjerash, u diskutuan tema të ndryshme që ndërlidhen me fushën e sigurisë si dhe të vazhimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it.



Komandantët amerikanë të Bondsteel-it u pritën në takim zyrtar nga u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Me 25.10.2022, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë, u. d. drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Fehmi HOTI me bashkëpunëtorë, priti në takim zyrtar komandantët amerikanë të Bondsteel-it: Col. Christopher SAMULSKI në përfundim të mandatit të tij dhe Col. Chris MABIS, i cili do ta zëvendësojë z. SAMULSKI në periudhën e ardhshme.

Gjatë këtij takimi u diskutuan tema të rëndësishme në interes të sigurisë si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të Policisë së Kosovës dhe Ushtrisë Amerikane, bashkëpunim ky i cili u rikonfirmua se do të vazhdojë edhe në të ardhmen në të mirë të sigurisë së përgjithshme në vend. Gjatë këtij takimi u shkëmbyen edhe mirënjohje.





Gjatë qëndrimit në Izrael u. d. drejtori z. Hoti, ka realizuar takim zyrtar me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Izraelit

U. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Fehmi Hoti, i shoqëruar nga drejtori i Divizionit për Hetimin e Krimeve, z. Fatos Makolli, po marrin pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve dhe Ekzekutivëve të LEA-s, e cila po zhvillohet në Izrael.

Në kuadër të kësaj vizite u realizuan takime të niveleve të larta, ndër to edhe takimi bilateral i realizuar me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Izraelit z. Yaakov Shabtai, me të cilin u diskutuan tema mjaft të rëndësishme në interes të organizatave policore. Ky takim kishte për qëllim të rrisë bashkëpunimin dhe avancimin drejt shkëmbimit të informacioneve, ofrimit të trajnimeve dhe përvojave më të mira ndërkombëtare në interes të organizatës policore, të cilat shërbejnë në zhvillimin dhe avancimin profesional të Policisë edhe në luftimin e

krimit të organizuar

dhe kërcënimeve ndërkombëtare.

U. d. drejtori z. Hoti falënderoi drejtorin e Izraelit z. Shabtai për pritjen e tij, për përkrahjen dhe mbështetjen në realizimin e kësaj vizite mjaft të rëndësishme për Policinë e Kosovës.



U. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës priti në takim drejtorin e Policisë së Shtetit



Me 18 nëntor 2022, u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Fehmi Hoti, ka pritur dhe ka zhvilluar një takim miqësor me drejtorin e Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë z. Muhamet RRUMBULLAKU.

Delegacioni i Policisë së Shtetit, i kryesuar nga drejtori i Përgjithshëm ka zhvilluar takim njohës me homologun nga Policia e Kosovës. Në takim pos dy krerëve të institucioneve, morën pjesë edhe manaxhmenti i lartë i Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shqipërisë.

Në takim, pas fjalëve përshëndetëse u diskutuan tema që lidhen me natyrën e punës policore, me theks të veçantë në bashkëpunimin mes dy policive të dy shteteve mike, si dhe u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Zotimi i dy përfaqësuesve kryesorë të dy institucioneve simotra, ishte se bashkëpunimi mes dy policive do të ngrihet në vazhdimësi dhe në të ardhmen do të vazhdojë edhe në fusha të reja me interes të përbashkët.



Një delegacion nga Departamenti i Mbrojtjes për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës vizitoi Policinë e Kosovës

Policinë e Kosovës e vizitoi një delegacion nga Departamenti i Mbrojtjes për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët ishin të shoqëruar nga përfaqësues të ICITAP-it dhe Ambasadës Amerikane.

Vizita e delegacionit nga SHBA-ja e kryesuar nga znj. Sofia Elgarresta, filloi me një takim mikpritës nga u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Fehmi Hoti me bashkëpunëtorë, i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë.

Gjatë këtij takimi u diskutua rreth bashkëpunimit dhe partneritetit reciprok në mes të Policisë së Kosovës dhe aleatëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Delegacioni nga SHBA-ja realizoi edhe disa vizita në disa njësi brenda PK-së, përfshirë Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit.



Në ambientet e Policisë së Kosovës takohen krerët e dy institucioneve

Shefi i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Lars-Gunnar Wigemark, u prit në takim zyrtar nga u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Fehmi Hoti, i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i Departamentit për Operacione z. Gazmend Hoxha.

Gjatë këtij takimi u diskutuan tema të ndryshme që ndërlidhen me fushën e sigurisë, e në veçanti vazhdimi i bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Policisë së Kosovës dhe EULEX-it, në interes të sigurisë së përgjithshme.

POLICIA KUFITARE PRANON DONACION NGA QEVERIA GJERMANE



Me datën 8 dhjetor 2022 Policia e Kosovës në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të saj, në një ceremoni të pranimit - dorëzimit, ka pranuar një donacion nga Qeveria Gjermane në vlerë rreth 500 mijë euro.

Në këtë ceremoni përveç u. d. drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Hoti dhe menaxhmentit të lartë të PK-së, të pranishëm ishin edhe ambasadori gjerman z. Rohde dhe ministri i Punëve të Brendshme z. Sveçla. Ky donacion

për Policinë e Kosovës i është dedikuar Policisë Kufitare dhe ka në përmbajtje 10 ATV - automjete (motorë 4X4 për patrullim në të gjitha llojet e terrenit), lloptop, si dhe pajisje tjera profesionale për mbikëqyrje dhe kontroll të kufirit. Përveç donacionit të ofruar, ambasadori gjerman theksoi se bashkëpunimi dhe partneriteti i krijuar ndër vite do të vazhdojë dhe shprehu gatishmërinë e Qeverisë Gjermane që edhe në të ardhmen të ndihmojë Policinë e

Kosovës.

Me këtë rast u.d. drejtori i Përgjithshëm i PK-së shprehu falënderim ndaj ambasadorit si dhe Ambasadës Gjermane për bashkëpunimin e ngushtë dhe mbështetjen për Policinë e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve përmes donacioneve të vazhdueshme si një partner strategjik i PK-së.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi - Gërxhaliu



42nd Capital Policing Europe Conference

KRYEQYTETI YNË PRISHTINË, NIKOQIRI DHE ORGANIZATORI I KËSAJ KONFERENCË, KU MORËN PJESË DREJTORËT DHE PËRFAQËSUESIT E 26 POLICIVE TË KRYEQYTETEVE EVROPIANE.



Konferenca e drejtorëve të policive të kryeqyteteve evropiane, është një ngjarje vjetore, që sjell së bashku krerët e Policisë së kryeqyteteve të Evropës, që prej edicionit të tij të parë, të mbajtur në vitin 1979 në qytetin e Londrës. Kosova, përkatësisht Drejtoria Rajonale e Policisë së Prishtinës nga viti 2016 ka marrë pjesë në këtë konferencë, fillimisht si vëzhgues në Budapest (Hungari), e më pas si anëtare e barabartë në vitin 2017 në Lisbonë (Portugali). Në vitin 2018 në Dublin të Irlandës është vendosur që kjo konferencë në vitin 2020 të mbahej në Prishtinë, mirëpo është anuluar për shkak të pandemisë



covid 19, e cila është organizuar pas dy vitesh në tetor 2022.

Drejtoria Rajonale e Policisë së Prishtinës, ishte nikoqiri dhe organizatori i kësaj konference, ku morën pjesë drejtorët dhe përfaqësuesit e 26 policive të kryeqyteteve evropiane.

Në hapjen e kësaj konference drejtori i Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, nënkolonel Fehmi Xhata, shpallosi para të pranishmëve një rezimë të etapave zhvillimore ndër vite të Policisë së Kosovës dhe Drejtorisë Rajonale të Prishtinës në veçanti.

Ndër të tjera nga drejtori rajonal është përcjellë mesazhi që Policia e Kosovës

POQIRE E KONFERENCËS SË 42-të, RË TË 26 KRYEQYTETEVE EVROPIANE



është e hapur për bashkëpunim me të gjitha policitë e shteteve pjesëmarrëse

dhe më gjerë, si dhe ka shprehur objektivin për anëtarësim në organizatat

ndërkombëtare, ku edhe është kërkuar mbështetje.



42nd Capital Policing Europe Conference

Prezantime gjatë sesioneve pati nga shumica e shteteve evropiane si dhe nga zyrtarë të Policisë së Kosovës nga njësitë e specializuara, fusha e hetimit të krimeve kibernetike të cilët prezantuan para pjesëmarrësve të arriturat dhe nivelin e shkallës profesionale të këtyre njësive.



Kjo gjë do të ndikojë në thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërkombëtar në sferën e sigurisë dhe shkëmbimin e përvojave të përparuara.



Konferenca e 42-të, e drejtorëve të policive të kryeqyteteve evropiane, ka mbyllur me sukses punimet e saja me nënshkrimin e deklaratës së përbashkët nga shtetet pjesëmarrëse, prej dhjetë pikash të nxjerra nga temat e trajtuara dhe diskutimet e zhvilluara përgjatë gjithë konferencës.

Në mënyrë që pjesëmarrësit të njihen më mirë me kryeqytetin e Kosovës, si pjesë e agjendës ka qenë edhe vizita e disa e vendeve me rëndësi të veçantë, që kanë të bëjnë me kulturën dhe historikun e Republikës së Kosovës, si Muzeu Etnologjik, Monumenti Newborn, Memoriali Heroinat, Katedralja Nëna Terezë si dhe Biblioteka Kombëtare, ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të vizitojnë dhe të dëgjojnë përmes ciceronëve rreth monumenteve/vendeve dhe historisë së tyre.



Qëllimi i kësaj konference ishte pikërisht bashkëpunimi dhe partneriteti ndërkombëtar në sferën e sigurisë dhe shkëmbimi i përvojave, ku lidhur me këtë është nënshkruar një deklaratë e përbashkët nga shtetet pjesëmarrëse, marrëveshje kjo e përbërë prej dhjetë pikash të nxjerra nga temat e trajtuara dhe diskutimet e zhvilluara përgjatë gjithë konferencës.

Shqipëria u zgjodh vendi ku do të mbahet konferenca e radhës, pra e 43-ta me radhë, ndërkaj Estonia do të jetë vendi mikpritës pas Shqipërisë.
Organizatorë të kësaj ngjarje ishin një grup zyrtarësh të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë.



42nd Capital Policing Europe Conference

Në vijim do të gjeni komentet dhe përshtypjet e disa vendeve pjesëmarrëse si: Zvicra, Estonia, Italia, Belgjika, Vatikani, Malta, Gjermania, Norvegjia, Shqipëria, Kroacia, Finlanda, Portugalia, Suedia, Luksemburgu, Hungaria, Islanda, Republika çeke, Polonia, Maqedonia e veriut, Austria dhe Bullgaria.

Swiss Bern Manuel Wili



Switzerland 🇨🇭 says thanks to Kosovo Police for the perfect organization of the CPE Conference in Pristina and the tremendous hospitality. Thanks to all participants for the exchange of experiences and the commitment to make Europe and their capitals to a safe place. Kind regards Manuel Willi



Urmet Tambre

October 29 at 1:02 PM · 🌐

Kosovo 42. Euroopa pealinnade politseijuhtide konverentsi lõppedes külastasime sealset etnoloogia muuseumi. Kirjutasime neile mälestuseks, et maailma parim politsei käis neil külas. Turvalisust taganud politseinikuga kiire foto ja ongi aeg koduteele asuda. Aitäh Kosovo! 🇮🇹 🇪🇺 🇨🇭

Kosovo 42. At the end of the conference of police chiefs of European capitals, we visited the ethnology museum there. We wrote to them as a memory that the best police in the world visited them. A quick photo with the policeman who was ensuring security and it's time to head home. Thank you Kosovo! 🇮🇹 🇪🇺 🇨🇭

🔍 Hide original · ⭐ Rate this translation



Massimo IMPROTA

🇮🇹 Italy salsa thanks to kossovo police for this experience in an unknown land with its traditions, history and great resilience; thanks to have given us the possibility to stay far from daily problems and to stay all together in amazing and intrsting days. Hopeing to stay with you next edition.....Massimo

7:45 AM



2

Says

7:46 AM

No salsa 🤔🤔

7:46 AM



Michel GOOVAERTS Belgium

Dear colleagues... thanks to everyone and our Kosovar colleagues in particular for the warm welcome and perfect organisation. It is always heartwarming to see how new friends are made in a few days. Thanks for everything and see you next year in albania. United we stand and always welcome in brussels. Greetings michel goovaerts

11:11 AM



Estonia

Behalf of Estonian delegation we would like to thank all of you and of course Kosovo colleagues for a such fruitful conference and the well organised programm and we really appreciated your hospitality. See you all in Albania and then Tallinn.

12:06 PM



Vaticano Stefano MARCON

on behalf of the Vatican Delegation a warm greeting to all of you and a special thanks to the Kosovo Police for the perfect and hospitable organization ... have a good return home!

12:49 PM



Jonathan RANSLEY Malta

This was my first experience at a conference, and thanks to the excellent hosts you surely made it a great experience to cherish. Thanks for everything

12:51 PM



Paolo Pereira Portugal 🇵🇹

On behalf of the portuguese delegation, I would like to thank to Kosovo Police for this great personal and professional experience in your country, with the purpose to have a europe more secure. Thanks also to all colleagues that made it un excellent moment.

1:01 PM

Sweden Yvonne FRIEDL

On behalf of the Swedish delegation I'm sending our thanks to the great people in the Kosovo police for the perfect arrengment and making the conference fruitful and special. We have new knowledge, colleagues and friends and alot of nice memories to bring home. Thank you and take care.



3:30 PM



Patrick EVEN LUX

Dear colleagues, thanks to everyone and especially to our colleagues from Kosovo for the warm welcome and perfect organisation.

Thank you also for sharing your experience and your friendship and i really hope to see you all next year in Albania.

Best Regards to all, Patrick from Luxembourg.



Massimo IMPROTA

3:10 PM



6:10 PM



3

Peter Farkas Hungaria

Dear Colleagues in Kosovo and around Europe, thank you for your kindness and the hospitality!

42nd Capital Policing Europe Conference

Croatia



Dear colleagues,
On behalf of the Croatian delegation, we attended this conference with pleasure. Thanks to all of you, organizers and participants, we really enjoyed in positive atmosphere..
Greetings Velimir Tišma

10.10.2022



Juha Hakola Fin



Dear friends, I want to thank everyone for the warm conference and good friendships. In these times, events like this are significant. Special thanks to the Kosovo Police for their hospitality and fantastic arrangements. Have a beautiful autumn and take care wherever you are! 🍷🇫🇮 Ps.

Germany

Dear all, it was a fabulous event, professionally, smoothly and flexibly organised. We could feel that you all were so committed to what you did. We met old friends and made new ones! We learned from each other and we had fun 🤔....stay safe, thank you and hope to see you at the next CPE! Warm regards from Germany 🇩🇪👍

4:02 PM

26.28 OCTOBER 2022

Norvegia

From the Norwegian delegation, a warm thanks for a great conference, with professional and welcoming arrangement down to every detail. We are so impressed. It was also very good meeting the European police-family, with so many great perspectives and knowledge! We wish you all a nice weekend! 🇳🇴🤗🍷

4:16 PM



Lorenc Panganika

Congratulations to Kosovo for the perfect hospitality and organization of this conference. I wish you all arrived safely in your countries. See you next year in Tirana. Greetings from Albania. 🇦🇱

10.10.2022

Iceland

Thank you Kosovo Police for the warm welcome and the great hospitality during the last days.

Thank you also for flawless organization of the conference and special thanks to all of you that gave us an insight in your tasks and challenges.

Many new friends met and also old ones and visits were planned.

Google says we have travelled 1872 km already and have 1878 km still to go 🤖.

Best regards from Reykjavik

7:33 PM



Czech Republic

Hello everyone. On behalf of the Czech delegation, I would like to say a big thank you for the great conference, organization and for the productive & fruitful atmosphere. Thank you for the warmest welcome to the Kosovo Police and the whole organizational team. We appreciate it so much and are glad we got to meet a lot of nice people and got many interesting insights. Greetings from 🇨🇪

7:35 PM

Slovenian delegation would like to thank the KPS hosts for an extremely well-prepared conference. It was nice to meet old friends again and meet new ones from our great international police family. It is very nice to see such a great progress in the development of KPS and Kosovo in general. It is a pleasant feeling when you see that our work 20+ years ago was useful and we did the right things. Good luck to everyone and see you again, hopefully in Tirana, if not sooner. We arrived home safely. Thank you /Falemindent shumë 🙌

Damjan and Robert with spouses

8:34 PM



Krzysztof Pacula Poland

On behalf of Warsaw Metropolitan Police I wanted to convey words of gratitude for organizing such a great conference. Thank you for the hospitality and productivity during the meetings and great atmosphere and entertainment after. 🇵🇱

8:44 PM



Muzafer Karisik Shkup

Good evening everyone, on behalf of the North Macedonia delegation, I would like to say a big thank you for the great conference, organization and for the productive & fruitful atmosphere. Thank you for the warmest welcome to the Kosovo Police and the whole organizational team. We appreciate it so much and are glad we got to meet a lot of nice people and got many interesting insights. Greetings from 🇲🇰

8:58 PM



Reinthal Austria

The Viennese delegation would also like to thank the Pristina Police for their warm welcome and hospitality

The conference was well organized and marked by heartiness and friendship.

We are looking forward to meeting again with our partners in joint cooperation for the security of our countries.

With gratitude,
Vienna Police

9:12 PM

42ND CAPITAL POLICING EUROPE CONFERENCE

26-28 OCTOBER 2022

Dear colleagues,

On behalf senior commissioner Kaloyan Miltenov, director of the Sofia Metropolitan Directorate of the Interior, I would like to express our gratitude for your hospitality and opportunity to participate in the 42nd CPE Prishtina 2022.

The event was really productive for our work and gave us very good insight on the tools and police methods used by our colleagues from the other European capitals.

Përgatiti: Blerinë Ejupi

Vizitë

Përfaqësues të zyrave për informim nga institucionet kosovare vizitojnë Holandën



Në dhjetor të këtij viti përfaqësuesit e zyrave për informim publik dhe media të Policisë së Kosovës, Prokurorisë Speciale, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës realizuan një vizitë studimore në Hagë. Agjenda përfshiu edhe vizitat në

- EUROPOL
- Dhomat e Specializuara të Kosovës
- Mekanizmin Rezidual Ndërkombëtar për Tribunalet Penale

Qëllimi i vizitave ishte për t'u njohur për së afërmi me strategjitë e komunikimit dhe programet sensibilizuese të tyre.

Pjesëmarrësit u pritën ngrohtësisht nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Holandë, i cili foli për prioritetet dhe fushat e angazhimit të kësaj ambasade.



STAFI CIVIL, SHTYLLË MBËSHTETËSE PËR POLICINË E KOSOVËS

Në Policinë e Kosovës, përveç zyrtarëve të uniformuar, punojnë edhe zyrtarë të stafit civil, të cilët janë shtyllë e fortë mbështetëse për institucionin.

Stafi civil i Policisë së Kosovës janë staf i punësuar për të kryer shërbime administrative apo mbështetëse, por të cilët nuk kanë autorizime policore.

Zyrtarja Xhevahire Berisha - Uka është zyrtarja e parë nga stafi civil e punësuar në Policinë e Kosovës.

Ajo me shumë ndjesi na e ka përshkruar gjithë rrugëtimin e saj në Polici.

Xhevahirja është lindur dhe rritur në Prishtinë, shkollën fillore e ka përfunduar në shkollën "Asim Vokshi" në Prishtinë, ndërsa të mesmen (pas një periudhe të mësimi nëpër shtëpi "shkolla", gjatë kohës së luftës) e përfundoi në shkollën "Sami Frashëri". Ka studiuar në fakultetin e Edukimit në Prishtinë në drejtimin Teknologji Informatike në Universitetin e Prishtinës.

Zyrtarja Berisha-Uka punën në Polici e filloi në moshë shumë të re, duke vendosur që ta sfidonte veten dhe t'iu hapte rrugë ëndrrave të saja: "Viti kur unë fillova punën ishte viti 2000, pak kohë pasi kishin filluar të formoheshin institucionet tona. Pata kënaqësinë që unë të jem zyrtarja e parë e stafit civil e punësuar në Policinë e Kosovës me numër të ID kartelës 0001.

Ndihesha e vlerësuar, fitova vetëbesim, u mbusha me vullnet që si një e re fitova një punë. Edhe më shumë më gëzonte fakti që tash e tutje do të shërbeja në një institucion të besueshëm siç është Policia.

**Zyrtarja
Xhevahire
Berisha - Uka
është zyrtarja e
parë nga stafi
civil e punësuar
në Policinë e
Kosovës.
Ajo me shumë
ndjesi na e ka
përshkruar
gjithë rrugëtimin
e saj në Polici.**



Si fillim kam punuar në Drejtorinë e Personelit, më saktësisht në Dhomën e dosjeve. Pas një përvoje 3 vjeçare në drejtim të studimeve dhe trajnimeve në fushën e Teknologjisë, në vitin 2003 kalova në departamentin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit. Që nga atëherë edhe sot vazhdoj të jem pjesë e stafit të mrekullueshëm të TIK-ut" - shtoi ajo.

Ajo ka theksuar se përveç privilegjit dhe ndjesisë së mirë që i ka dhënë dhe ia jep puna, ajo bart edhe shumë përgjegjësi, madje ajo përmend se si zyrtarja e parë civile ka dashur të jetë një shembull i mirë për ata që janë punësuar më pas, duke dhënë më shumë nga vetja.

Nga eksperiencia e saj 22 vjeçare në Polici ajo përmend momente të ndryshme që mund të kenë qenë të veçanta: "Në përgjithësi çdo ditë ka qenë e mirë dhe e veçantë, e karakterizuar me natyrë të ndryshme e shpesh edhe sfiduese".

Profili i punës së zyrtares sonë është i një rëndësie të veçantë, sidomos në ditët

e sotme ku zhvillimi i teknologjisë ka marrë hov të madh dhe digjitalizimi në shumë sfera është zgjidhja më e lehtë për ofrim të shërbimeve për qytetarë.

Në departamentin e TIK-ut, ku ajo punon, detyrë e saj është që të mirëmbajë dhe administrojë aplikacione me të cilat Policia e Kosovës menaxhon dhe zhvillon punën e përditshme si brenda ashtu edhe nëpër terrene të ndryshme.

"Ndihej shumë mirë! Vetë fakti që jam ende pjesë e Policisë tregon se punën që e bëj më pëlqen, e admiroj dhe çdo punë e marr me përkushtim dhe seriozitet.

Vetë teknologjia është sferë që shfaq gjithnjë risi, andaj të bën që të mos mërzhitesh sepse puna nuk bëhet rutinore".

Xhevahirja përveç studimeve në drejtimin e Teknologjisë Informative ka përfunduar edhe trajnime të ndryshme të kësaj lëmie si dhe shumë seminare brenda dhe jashtë vendit.

Duke e vlerësuar shumë institucionin ku punon ka vendosur që 22 vitet e përvojes dhe kontributit t'ia falë me kënaqësi Policisë.

Ajo është e martuar, nënë e katër vajzave dhe familja është ajo që përveç sakrificës edhe e përmbush shumë shpirtërisht!

Edhe sot ajo është krenare me Policinë e Kosovës!

Policia është institucion i cili i mbështet profesionistët dhe iu jep hapësirë për punë.

Merita Canolli - Gashi

HEROIZMI I POLICISË GJATË PUNËS

Pjesëtarët e Policisë së Kosovës gjatë punëve të përditshme, në vazhdimësi sfidohen me të papriturën.

Në çdo ditë pune zyrtarët e Policisë i pret e panjohura dhe vështirësia por gjithnjë punojnë duke qenë të mbushur me ndjenjën e përgjegjësisë dhe humanitetit.

Gjatë vitit 2021, në një rast të komplikuar, tre zyrtarë policorë reagues me të gjitha

forcat si fizike dhe profesionale po ashtu edhe psikologjike dhe humane, duke arritur te qëllimi i madh.

Me datën 28.06.2021, në stacionin policor 'Jugu', ka ardhur informacioni se në një ndërtesë kolektive, nga kati i tetë i saj, një person kishte kërcënuar se do të bënte vetëvrasje. Me të marrë informatën kishin reaguar njësitë policore të rendit dhe të hetuesisë.

Gjithashtu, me urdhër të komandantit të Njesisë Speciale Operative, vendit të ngjarjes i është përgjigjur edhe kapiteni Fatmir Balaj, i cili është i trajnuar për të negociuar, bashkë me dy zyrtarët, rreshterin Rrahman Berisha dhe operatorin Fisnik Gashin (pjesëtarë të NJSO-së), për të ndihmuar në administrimin e rastit 'tentim vetëvrasje'.

Duke i shfrytëzuar mirëfilli aftësitë e tyre profesionale dhe veçanërisht ato negociuese e psikofizike, duke kaluar nga njëri ballkon në tjetrin, duke përdorur aksesore/litarë dhe mjete për siguri, kanë arritur ta shpëtojnë jetën e qytetarit i cili kishte kërcënuar se do t'i japë fund jetës duke kërcyer nga lartësia.


Veprimet e jashtëzakonshme dhe në kohën e duhur të zyrtarëve policorë, bënë që qytetarit t'i shpëtohet jeta dhe t'i ofrohet edhe ndihma mjekësore e psikologjike.

Ata veprën e humanitetit e kryen edhe pa qenë



Në çdo ditë pune zyrtarët e Policisë i pret e panjohura dhe vështirësia por gjithnjë punojnë duke qenë të mbushur me ndjenjën e përgjegjësisë dhe humanitetit.

Gjatë vitit 2021, në një rast të komplikuar, tre zyrtarë policorë reagues me të gjitha forcat si fizike dhe profesionale po ashtu edhe psikologjike dhe humane, duke arritur te qëllimi i madh.



në orar të rregullt pune, duke e ndjerë përgjegjësinë dhe duke i dhënë kuptim epitetit që mbajnë.

Me këtë rast, Ministria e Punëve të Brendshme në koordinim me Policinë e Kosovës, për veprën e bërë, i shpërblen pjesëtarët e saj me medaljen "SHPËTIM JETE".

Policia vazhdon të krenohet me vullnetin e pakursyer dhe punën profesionale të zyrtarëve të saj.

Organizata u është mirënjohëse punonjësve të saj që vazhdimisht ia rrisin vlerën me besueshmëri dhe me profesionalizëm.

Policia i nderon ata që i japin nder!

Përgatiti: Merita Canolli – Gashi





U mbajt takimi i 20-të i Këshillit Ekzekutiv të Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve)

Policia e Kosovës, institucion i ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në kuadër të autorizimeve dhe detyrave ditore prioritet ka partneritetin me qytetarë, me ç'rast në vazhdimësi synon këtë bashkëpunim ta rrisë dhe ta forcojë. Në vazhden e realizimit të aktiviteteve, me qëllim rritjen dhe forcimin e komiteteve lokale për

siguri publike, me datën 9 dhjetor, në bashkëpunim me Komitetin Lokal për Siguri Publike në Obiliq dhe me mbështetjen e vazhdueshme të OSBE-së, u realizua takimi i 20-të me radhë i KLSP-ve, takim ky që solli të gjithë akterët që ndihmojnë dhe forcojnë bashkëpunimin, si: zyrtarë nga MPB-ja, kryetari i Komunës së Obiliqit,

përfaqësues nga KLSP-të në nivel vendi, zyrtarë nga Agjensionin për Menaxhimin e Emergjencave, zyrtarë policorë. Në takim u shpalosën projektet nga KLSP-të, u ndanë mirënjohje nga OSBE-ja, disa përfaqësuesve të KLSP-ve, u përmendën sfidat dhe në fund u rekomandua që të gjithë të kontribuojnë në rritjen e sigurisë në përgjithësi.



MBRESAT DHE KRENARIA GJATË TRAJNIMIT TË MBAJTUR NË EMIRATET



E veçantë e theksuar gjatë këtij organizimi ishte edhe se për herë të parë në Emiratet e Bashkuara Arabe në fund të trajnimit, gjatë ceremonisë së diplomimit ku mori pjesë edhe ambasadori i Kosovës, në mesin e flamujve të shteteve pjesëmarrëse valoi edhe flamuri i Kosovës.

Gjatë periudhës shtator–nëntor 2022, me iniciativë të ish-presidentes Jahjaga dhe Qeverisë së Kosovës, u organizua trajnimi intensiv për ushtaret dhe policet femra me temë “Gratë, paqja dhe siguria” i cili është organizuar nga organizata “WOMAN” dhe pjesëmarrëse kanë qenë 15 vende të botës, duke përfshirë për herë të parë edhe Kosovën.

Pjesëmarrëse ishin 157 zyrtare nga

vendet arabe si Afrika dhe Azia, të cilat zhvilluan trajnimin intensiv ushtarak në Shkollën Ushtarake “Khawla bint Al Azwar”, brenda bazës së Forcave të Armatosura të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Gjatë kursit, pjesëmarrëset kaluan tetë javë trajnim ushtarak dhe dy javë pjesë teorike për funksionimin e OKB-së si dhe misionet paqeruajtëse.

Kurset e trajnimit kishin përmbajtje

manovrimin me armë (weapon handling), gjuajtjet simuluese me armë të shkurtra dhe të gjata, gjuajtje reale me armë, ndihmë të parë për në zonë konflikti (first aid under fire) si dhe përdorim të pajisjeve të ndihmës së parë në të cilat janë të trajnuara edhe ushtaret e NATO-s si dhe trupat e misioneve të OKB-së, topografi apo orientim me harta, kompas si dhe pajisje teknologjike si GPS, taktika mbrojtje si Jiu- Jitsu si dhe ushtrime dhe stërvitje (combats and drills) për të qenë të përgatitura dhe për të qenë të gatshme për zona konflikti.

Qëllimi i trajnimit ishte që të përgatisë pjesëmarrëse me aftësi fizike, ushtarake dhe psikike, për të qenë pjesë e misioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara (OKB) në zona post konfliktit, të cilat zona mund të jenë disa nga pjesët më armiqësore të botës, nga efektet e luftës, ku armëpushimet mund të jenë të brishta.

Pjesë e trajnimit po ashtu kanë qenë ushtrimet fizike si dhe parada e pjesëmarrëseve me koreografi për ceremoninë finale.

Ky trajnim është fillimi i iniciativës që edhe gratë nga Kosova të ndihmojnë dhe të kontribuojnë në sigurinë e



UNIMIT 'GRATË, PAQJA DHE SIGURIA', ET E BASHKUARA ARABE

përgjithshme në botë si dhe në sigurinë e viktimitave të konfliktit në botë.

E veçantë e theksuar gjatë këtij organizimi ishte edhe se për herë të parë në Emiratet e Bashkuara Arabe në fund të trajnimit, gjatë ceremonisë së diplomimit ku mori pjesë edhe ambasadori i Kosovës, në mesin e flamujve të shteteve pjesëmarrëse valoi edhe flamuri i Kosovës.

Rritja e përfaqësimit të grave në misione paqeruajtëse është thelbësore, duke pasur parasysh se gjysma e popullatës së botës janë gra dhe fëmijë. Megjithatë gratë po luajnë gjithnjë e më shumë një rol të rëndësishëm në misionet paqeruajtëse të OKB-së, ende duhet bërë përpunim në këtë drejtim.

Gjatë trajnimit, përmes intervistave për medime të ndryshme në Emiratet e Bashkuara Arabe, u promovuan vlerat si dhe kapacitetet e PK-së dhe FSK-së që mund të ofrojnë si kontribuuese të paqes në botë.

Major Luljeta Mehmeti Quigley nga Policia e Kosovës në një nga këto intervista për televizionin "The National", ndër të tjera theksoi: "Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në

misionet paqeruajtëse të OKB-së është më e rëndësishme se kurrë më parë, gratë paqeruajtëse mund të sjellin një perspektivë të ndryshme dhe ato janë të afta të shërbejnë njësoj si burrat kudo në çdo mision paqeruajtës. Populli i Kosovës si dhe unë personalisht kemi përjetuar luftën dhe pasojat e saj, andaj më së miri kuptojmë dhe ndjejmë rëndësinë e misioneve paqeruajtëse për njerëzit kur kanë nevojë për ndihmë".

Ajo i falënderoi Emiratet e Bashkuara arabe për mundësinë e dhënë që gratë nga Kosova të jenë pjesë e këtij trajnimit, duke bërë që ky të jetë një hap i parë që gratë nga Kosova t'iu bashkëngjiten misioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe të kontribuojnë për paqen dhe sigurinë në botë.

Përveç përvojës dhe mësimave gjatë këtij kursi, major Luljeta na ka treguar se edhe lidhja e miqësisë në mes të pjesëmarrësve, duke shkëmbyer njohje për traditat dhe zakonet, i ka lënë mbresa.

Përgatiti: Merita Canolli- Gashi



Operacione

Arrestohen dy të dyshuar për përfshirje në veprën penale 'falsifikim i parasë'



Hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), të mbështetur edhe nga institucionet e tjera të zbatimit të ligjit dhe në koordinim me Prokurorinë Themelore në Ferizaj, me 09.12.2022, ka zhvilluar operacionin policor, me qëllim të arrestimit të dy personave të dyshuar. Arrestimi ka ardhur pas një pune operative dhe hetimore, pasi Policia kishte rënë në gjurmë të të dyshuarve dhe më pas ka rezultuar me arrestimin në flagrancë të dy të dyshuarve: B. S., (viti i lindjes 1986, mashkull kosovar) dhe M. I., (viti i lindjes 1986, mashkull shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut). Të dyshuarit kishin tentuar të vënë në qarkullim një shumë të parave të falsifikuara me vlerë të përgjithshme prej 53100 (pesëdhjetë e tremijë e njëqind euro) si dhe 10000 (dhjetë mijë dollarë amerikanë).

Gjatë këtij operacioni është kryer edhe kontrollimi i shtëpisë së të dyshuarit shtetas kosovar. Gjatë operacionit policor, si prova materiale që do të përdoren në procedurë të mëtejme, janë sekuestruar: 700x50 € = 35000 €, 181x100 € = 18100 €, 100x100 \$ dollarë amerikanë, 2 vetura dhe 3 telefona.

Të gjitha veprimet janë kryer me autorizimin e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Ferizaj, me vendimin e të cilit të dyshuarve iu është shqiptuar masa e ndalimit prej 48 orëve.



Arrestohen dy persona të dyshuar, konfiskohet drogë dhe municion

Hetuesit policorë nga njësia e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në Pejë, si rezultat i hetimit të një rasti të mëhershëm, ku janë aplikuar edhe masat e veçanta, pas një pune operative-hetimore në terren me datën 06.12.2022 kanë zhvilluar një operacion të shpejtë-taktik të koduar me emrin "Rrufeja", me ç'rast është ndaluar vetura e tipit GOLF-VII, ngjyrë e kaltër, të cilën ishte duke e drejtuar i dyshuari N. D. (1975 mashkull kosovar), ku pasagjer ishte i dyshuari tjetër B. K. (1973 mashkull kosovar).

Pas kontrollit në trupin e të dyshuarit të parë është gjetur dhe është konfiskuar sasi e lëndës së dyshuar narkotike e llojit heroinë, ku në konsultim me prokurorin kujdestar dhe me urdhër të GJPP është realizuar kontroll tek shtëpitë e të dyshuarve, ku janë gjetur dhe janë konfiskuar dëshmitë relevante si në vijim:

- kokainë në peshë 234.3 gramë,
- heroinë në peshë 412.6 gramë,
- njëzet e nëntë (29) fishekë kal. 9 mm, si dhe
- tre (3) telefona mobilë.

Dyshohet se substancat narkotike kanë qenë të destinuara për tregun lokal. Të dyshuarit janë intervistuar në prani të

avokatëve mbrojtës dhe me urdhër të prokurorit janë ndaluar për 48 orë.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në parandalimin e të gjitha dukurive negative dhe veprave penale në vend, në veçanti luftë e pa kompromis do të zhvillohet ndaj atyre që merren me abuzimin e substancave narkotike.

Arrestohet personi i kërkuar nga INTERPOL-i

Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, Njësi Rajonal i Komunikacionit Rrugor me datën 26.11.2022 në rrugën e Kamenicës në një pikë kontrolli rutinë me radar ka



ndalur një automjet me tabelat vendore (01) të cilin e drejtonte A. A. shtetas i Kosovës, për shkak të tejkalimit të shpejtësisë.

I njëjti pasi është verifikuar nga ana e zyrtarëve policorë ka rezultuar se është i kërkuar nga INTERPOL-i për shkak të veprës penale 'vjedhje e rëndë' të kryer jashtë shtetit të Kosovës.

I njëjti është arrestuar nga ana e zyrtarëve policorë dhe është sjellë në Stacionin Policor Gjilan për procedim të mëtejme ligjor.

Raportohet 'dhunë në familje', sekuestrohen dy armë zjarri

Me datën 5 dhjetor 2022, në Stacionin Policor Suharekë raportohet për rast dhunë në familje' në fshatin Mushtisht. Rastit të raportuar, në vendin e ngjarjes i janë përgjigjur njësitë relevante policore,

njësitë patrulluese, ato të hetimeve dhe hetuesi i rasteve 'dhunë në familje', të cilët i ndërmarrin masat e duhura. Identifikohet personi i dyshuar E. M. (46 vjeç), i cili arrestohet për shkak të dyshimit se i njëjti në mënyrë sistematike ka ushtruar dhunë kundër familjarëve të tij. I dyshuari e ka kërcënuar me vrasje bashkëshorten e tij.

Gjatë ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme ligjore nga ana e hetueseve policorë, në vendin e ngjarjes, respektivisht në njërën prej dhomave në shtëpinë e të dyshuarit janë gjetur dy armë zjarri: një pistoletë, një pushkë dhe 16 fishekë, të cilat më pas sekuestrohen



në cilësi të dëshmisë materiale.

Kundër të dyshuarit është iniciuar procedura penale për veprën 'dhunë në familje' si dhe 'mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve'.

Lidhur me këtë njoftohet prokurori i shtetit, me aktvendim me shkrim të të cilit të dyshuarit i shqiptohet masa e ndalimit policor për 48 orë.

Policia Kufitare e Kosovës parandalon dy raste të kontrabandimit me mallra

Policia e Kosovës, njësia policore Task Forca nga Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare (DRPK) Lindje, në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës, kanë intensifikuar kontrollet taktike dhe operacionet në terren.

Njësia e Task Forcës pranë DRPK-Lindje ka ndërmarrë masa të nevojshme operativo-taktike duke bërë prita dhe kontrolle në rrugët e brezit kufitar dhe rrugët dytësore dhe rajonale, ku si

rezultat i kësaj janë parandaluar dy raste të kontrabandës me mallra.

Rasti 1: me datën 29.11.2022 rreth orës 15:20 nga njësia e Task Forcës është vërejtur një automjet i dyshuar duke hyrë në territorin e RKS-së nga fshati Breznicë, Republika e Serbisë.

I njëjti automjet është përcjellë dhe është ndaluar më vonë në Gjilan me drejtues A. A. mashkull kosovar, i njohur për Policinë si recidivist i veprave penale të kontrabandimit të mallrave.

Gjatë kontrollit tek i njëjti në bagazh të veturës dhe ulëseve prapa kishte pasur të ngarkuara rreth 300 kg. fruta (kumbulla të thara) të përpunuara për të cilat nuk kishte asnjë dokument përcjellës për origjinën dhe përmbajtjen e tyre, të cilat dyshohet se janë sjellë nga Republika e Serbisë.

Rasti 2: Me datën 29.11.2022 rreth orës 21:00 nga njësia e Task Forcës në ardhje nga Maqedonia e Veriut me dyshimin për mall të kontrabanduar është ndaluar në fshatin Stubëll, komuna e Vitisë, automjeti BMW X5 ngjyrë hiri me targa vendore me drejtues K. M. mashkull kosovar si dhe përgjegjësi i mallit J. K. mashkull kosovar.

Gjatë kontrollit të automjetit është parë se kishin të ngarkuar rreth 15 thasë duhan të përpunuar të cilin të dyshuarit e kishin marrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të dyshuarit mallin kishin në plan për ta dërguar te një person në një fshat të



komunës së Vitisë, ku nga njësia e Task Forcës është identifikuar edhe personi i tretë në rast, tek shtëpia e të cilit janë sekuestruar edhe 10 thasë duhan të njëjtë.

Për të gjitha këto veprime është njoftuar edhe prokurori kujdestar i shtetit, i cili ka urdhëruar që rastet të iniciohet 'kontrabandim me mallra', kurse malli të sekuestrohet dhe të dërgohet në Doganë.

Rastet janë duke u trajtuar nga njësitë përkatëse policore nga Drejtoria Rajonale Kufitare Lindje në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe Doganën e Kosovës.

Inspektohen 53 sallone të masazheve, mbyllen 44 prej tyre, gjatë një operacioni të Policisë me inspektorët kompetentë

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, me qëllim të marrjes së masave proaktive dhe verifikimin e informatave në terren, ka hartuar një plan operativ në funksion të inspektimit të salloneve të masazheve, plan i cili është realizuar në bashkëpunim dhe mbështetje të inspektorëve nga MINT, ATK-së dhe inspektorët e punës.

Me datën 07.12.2022, plani operativ i koduar "Masazh-dhjetori-2022", është realizuar në nivel vendi dhe ka përfunduar me sukses të plotë.

Aktivitetet parandaluese dhe rezultatet e këtij operacioni i gjeni në vijim të përmbledhura në formë tabelore:

✓ Lokale të Inspektuara (53 gjithsej)		
✓ Prej tyre 44 lokale janë mbyllur nga Inspektorët, si dhe janë shpallur gjëra për përmbytje të evidentuara.		
✓ Personat të LEGJITIMAB	Moshë	29
	Sexi	116
	TOTALI: 143	
	Shënime të AL-së	18
	Shënime të Taktikës	09
Shënime të Rumanisë	01	
Shënime të RKS-së	120	
✓ Shënime të tjera në marrëveshje të parafirmuar me ligjin në të cilin është bërë përmendja me Drejtorinë për Migrim dhe Hajat dhe të raportit në bazë të ligjit për të bërë.		

Ndal dhunën në familje

Policia e Kosovës në fushatën 16 ditore kundër dhunës në familje

Policia e Kosovës, si institucion i ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në kuadër të detyrave dhe autorizimeve që i përkasin, që nga themelimi i saj ka trajtuar me seriozitetin e duhur rastet e dhunës në familje, me ç'rast në vazhdimësi ka realizuar edhe fushata vetëdijesuese për pasojat e dhunës në familje, duke potencuar se dhuna nuk ndalet pa u raportuar dhe pa u trajtuar nga organet kompetente.

Duke ditur ndjeshmërinë e tyre dhe qasjen e Policisë karshi rasteve të dhunës në familje është bërë parandalimi i

dhunës në njërën anë si dhe trajtimi i rasteve me seriozitet, ka bërë që raste e tilla të vijnë duke u raportuar më shpesh, ndër vite. Në vazhdimësi të realizimit të aktiviteteve, me qëllim parandalimin e rasteve të tilla, me datën 25.11.2022, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me zyrën e UN-Women, ka filluar zbatimin e fushatës sensibilizuese "16 ditë aktivizimi kundër dhunës në familje". Kjo fushatë do të realizohet përmes shpërndarjes së materialit promovues – fletushkave, të cilat përmbajnë këshilla për ndërmarrjen e masave në parandalimin e dhunës në

familje si dhe raportimin e këtyre rasteve në Policinë e Kosovës që bartin mesazhin "Ndal dhunën në familje", ku të njëjtat do të shpërndahen tek qytetarët e të gjitha qyteteve të Kosovës pavarësisht moshës. Kjo fushatë sensibilizuese do të vazhdojë deri me datën 10 dhjetor 2022 me aktivitete të ndryshme sensibilizuese, siç janë: takimet njoftuese me qytetarë, ligjërata në institucione shkollore, takime në nivelin e institucioneve shtetërore, duke mos lënë anash edhe segmentin e rëndësishëm dhe kontribuues pra angazhimin e shoqërisë civile.

NDAL DHUNËN NË FAMILJE

Cdo veprim nga një anëtar i familjes ndaj anëtarit tjetër të familjes, që cenon integritetin fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik të tij është dhunë në familje.

Se beghes mund t'ia dalim, ti themi 'Stop Dhunë'

PASOJAT E DHUNËS:

- Pasojat psikike;
- Pasojat fizike;
- Humbja e harmonisë familjare;
- Rritja e numrit të divorceve;
- Fëmijë pa përkujdesje;
- Rritje e aktivitetëve kriminalë.

JU (VIKTIMA) KENI TË DREJTË:

- Të jetoni të lirë nga frikë;
- Të raportoni dhunë në familje në stacionin më të afërt policor;
- Të trajtoheni me dinjitet;
- Të keni ndihmë ligjore falas;
- Të jtu ofrohet mbrojtje e menjpërhshme;
- Të kërkontë strehim në Qendrën për Viktimat e Dhunës;
- Të kërkontë kompensim për dëmin që ju është shkaktuar.

Policia e Kosovës

NDAL DHUNËN NË FAMILJE

Jeto i lumtur

Parandalimi i Dhunës në familje na përket të gjithëve

ÇFARË MUND TË BËJË POLICIA PËR JU?

- Të përgjigjet thirrjes suaj sa më shpejt;
- Të parandalojë dhunën;
- Të arrestojë kryesin e dhunës;
- Të ofrojë siguri;
- Të ofrojë mbrojtje ligjore;
- Të ofrojë ndihmë mjekësore;
- Të ofrojë strehim në strehimore;
- Të trajtojë rastin në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, mbrojtësin e viktimave dhe aktorët e tjerë;
- Të hetojë rastin në koordinim me prokurorin.

RAPORTO DHUNËN NË POLICINË E KOSOVËS PËRMES:

- 092 nga telefonia fikse
- 902 nga VALA
- 922 nga PNO
- 0800/9999
- info@kosovapolica.com
- Aplikacioni digital 'Lumtur Policia'

Mos hesht, RAPORTO, sepse me heshtje e lejojmë dhunën në familje!

**UDHËZUESI INFORMUES
PËR LEHTËSIMIN E
KOMUNIKIMIT NË MES TË
POLICISË SË KOSOVËS DHE
PERSONAVE TË SHURDHËR**

Divizioni i Komunikacionit Rrugor i Policisë së Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve kanë lansuar UDHËZUESIN informues për lehtësimin e komunikimit në mes të Policisë së Kosovës dhe personave të shurdhër/gjysmë të shurdhër, të cilët drejtojnë mjetet në trafikun rrugor.

Udhëzuesi shërben për njoftimin e shoferëve të shurdhër/gjysmë të shurdhër për arsyen e ndaljes dhe njëkohësisht shërben edhe për nevoja tjera për ndihmë nga ana e pjesëtarëve të këtij komuniteti, gjithashtu në raste të veçanta përmes udhëzuesit të cilin do ta mbajnë me vete, secilit pjesëmarrës-drejtues i shurdhër/gjysmë i shurdhër do t'i mundësohet komunikimi përmes interpretit.



Policia e Kosovës, e përkushtuar në ofrimin e sigurisë dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me qytetarë

Policia e Kosovës po punon me përkushtim për të ofruar siguri në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë parandalimin e kriminalitetit, luftimin e dukurive negative, menaxhimin dhe kontrollin e kufirit, mundësimin e lëvizjes së lirë si dhe respektimin e të drejtave njerëzore. Me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit, komunikimit të ndërsjellë me qytetarët dhe ofrimin e mundësisë për lajmërimin e rasteve të ndryshme në të gjitha rajonet dhe stacionet policore, Policia e Kosovës ka të publikuar edhe numrat kontaktues pa pagesë (192, 0800 19999, 038 550 999), si dhe numrat e të gjitha stacioneve policore, përfshirë e-mailin zyrtar info@kosovopolice.com.



PROGRAMI RAPORTIMI DIGJITAL APLIKACIONI 'LAJMËRO POLICINË'



Policia e Kosovës, me qëllim të krijimit të mundësive shtesë për bashkëpunim, komunikim dhe raportim të rasteve kriminale, ka ofruar dhe njëherit ka publikuar platformën digjitale "LAJMËRO POLICINË", e cila mund të përdoret dhe shkakohet në pajisjet mobile në të tri gjuhët, shqip, serbisht dhe anglisht. Që nga lancimi i këtij aplikacioni në Policinë e Kosovës në nivel vendi janë raportuar rreth (10.700) raste të ndryshme, që ndërlihen me trafikun rrugor, posedim të armëve, drogës, raste të dhunës, korrupsionit etj. Duke vlerësuar lart bashkëpunimin me qytetarët dhe raportimet përmes kësaj platforme, Policia e Kosovës falënderon qytetarët për raportimin e rasteve të ndry-

shme dhe bashkëpunimin e ofruar në arritjen e objektivave të përbashkëta për garantimin e një sigurie të përgjithshme dhe inkurajon të gjithë qytetarët pa dallim në të gjitha rajonet policore, posaçërisht në rajonin e Mitrovicës Veri, që edhe më tutje rastet të raportohen pa hezitim në mënyrën më të lehtë dhe më të qasshme për ta.

Të gjitha raportimet nga ana e qytetarëve përmes këtij aplikacioni ofrojnë transparencë, konfidentalitet dhe anonimitet të plotë. Në bashkëngjitje në gjuhët (shqip dhe serbisht) keni, dy videoe spote sensibilizuese, broshurat sensibilizuese, modulim me sqarimet se si ta shkarkoni dhe përdorni aplikacionin "LAJMËRO POLICINË".

Përgatiti: Çajup Kajtazi

Info.

Numrat e Stacioneve Policore

Rajoni i Prishtinës

Drejtoria Regionale Prishtinë	038/ 540 021
Trafiku Rajonal Prishtinë	038/ 534 234
Stacioni Policor Obiliq	038/ 561 600
Stacioni Policor Fushë Kosova	038/ 535 812
Stacioni Policor Graçanica	038/ 564 292
Stacioni Policor Lipjan	038/ 581 010
Stacioni Policor Drenas	038/ 584 092
Stacioni Policor Podujevë	038/ 571 805
Stacioni Policor Veriu	038/ 249 942
Stacioni Policor Jug	038/ 549 924
Stacioni Policor Qendra	038/ 502 223
N/Stacioni Policor Orllan	038/ 614 972
N/Stacioni Policor Bernicë	038/ 515 092
N/Stacioni Policor Magure	038/ 502 472
Nenstacioni Policor Janjevë	038/ 567 009

Rajoni i Pejës

Drejtoria Regionale Pejë	039/ 432 327
Stacioni Policor Pejë	039/ 433 273
Trafiku Rajonal Pejë	039/ 432 595
Stacioni Policor Istog	039/ 451 374
Stacioni Policor Klinë	039/ 471 199
Stacioni Policor Deçan	039/ 361 020
Nën Stacioni Policor Junik	039/ 370 092
Nën Stacioni Policor Vitomiricë	039/ 442 203
Nën Stacioni Policor Ponasheve	039/ 370 888

Rajoni i Gjakovës

Drejtoria Regionale Gjakovë	038/ 504 504
Trafiku Rajonal Gjakovë	039/ 323 784
Stacioni Policor Gjakovë	039/ 322 482
Stacioni Policor Rahovec	029/ 277 913
Stacioni Policor Malishevë	038/ 269 007

Rajoni i Mitrovicës - Jug

Drejtoria Regionale Mitrovicë	028/ 532 366
Njesia e Trafikut Rajonal Mitrovicë	028/ 532 628
Stacioni Policor Mitrovicë Jug	028/ 532 585
Stacioni Policor Skenderaj	028/ 582 087
Stacioni Policor Vushtrri	028/ 572 010

Rajoni i Mitrovicës - Veri

Stacioni Policor/Regjioni Mitrovicë Veri	028/ 425 170
Stacioni Policor ZubinPotok	028/ 461 042
Stacioni Policor Zveqan	028/ 665 130
Stacioni Policor Leposaviq	028/ 83 424
Nën Stacioni Policor Prilluzhe	028/ 573 509

Rajoni i Prizrenit

Drejtoria Regionale Prizren	029/ 244 355
Trafiku Regional Prizren	029/ 244 655
Stacioni Policor Suharekë	029/ 271 024
Stacioni Policor Dragash	029/ 281 017
Nënstacioni Policor Sredskë	038/ 502 575
Nënstacioni Policor Mushtisht	029/ 275 105
Nënstacioni Policor Mamushë	029/ 273 453
Nënstacioni Policor Zhur	029/ 625 092

Rajoni i Gjilanit

Drejtoria Regionale Gjilan	0280/ 330 188
Stacioni Policor Gjilan	0280/ 330 061
Trafiku Regional Gjilan	0280/ 330 091
Stacioni Policor Novohera	038/ 576 092
Stacioni Policor Viti	0280/ 381 513
Stacioni Policor Kamenica	0280/ 372 390
Nënstacioni Policor Klllokot	0280/ 381 094
Nënstacioni Policor Ranillug	038/ 504 504
Nënstacioni Policor Zheger	0280/ 386 011
Nënstacioni Policor Pozharan	0280/ 386-269
Nënstacioni Policor Muqiverrë	0280/ 320 197

Rajoni i Ferizajit

Drejtoria Regionale Ferizaj	0290/ 322 406
Stacioni Policor Ferizaj	0290/ 327 412
Trafiku Regional Ferizaj	0290/ 321 899
Stacioni Policor Shtërpçë	0290/ 70092
Stacioni Policor Kaçanik	0290/ 380 834
Stacioni Policor Hani i Elezit	0290/ 385 015
Stacioni Policor Shtime	0290/ 389 008

Policia Kufitare

Stacioni Policor Kufitar ANP 'Adem Jashari'	038/ 594 451
Drejtoria Rajonale Kufitare 'Veri' Lluzhan	038/ 575 622
Drejtoria Rajonale Kufitare 'Lindje' Kaçanik	038/ 290 380
Drejtoria Rajonale 'Perëndimi' Gjakovë	038/ 504 504

Sindikata e Policisë së Kosovës nderon 22 heronjtë e PK-së, të cilët kanë rënë në kryerje të detyrës zyrtare



Me 4 nëntor 2022 në Pejë, Sindikata e Policisë së Kosovës hapi turneun tradicional të lojërave sportive i cili organizohet në shenjë nderimi dhe përkujtimi të zyrtarëve policorë të rënë në kryerje të detyrës.

Në këtë event sportiv të organizuar nga Sindikata e Policisë së Kosovës morën pjesë përfaqësues nga sindikatat e vendeve mike nga rajoni dhe më gjerë, përfaqësues nga Komuna e Pejës, familjarë të policëve të rënë në kryerje të detyrës dhe menaxhmenti policor nga niveli qendror dhe ai lokal.

Sindikata e PK-së në shenjë falënderimi ndau mirënjohje për përfaqësuesit e sindikatave nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe përfaqësuesit nga Kuvendi Komunal i Pejës.

Po ashtu, Sindikata e PK-së ndau një mirënjohje të veçantë për Këshillin Evropian të Sindikatave Policore (CESP) të cilët përmes zëvendëssekretarit të tyre, kishin adresuar një letër falënderimi për sindikatën e PK-së.

Gjatë këtij eventi sportiv, Sindikatës së Policisë së Kosovës, ngazëvendëssekretari i përgjithshëm i Këshillit Evropian të Sindikatave Policore (CESP), z. Marian Kicev, iu kumtua lajmi pozitiv se Sindikatës së PK-së i është pranuar kandidatura në anëtarësim të CESP-s. Në rastin e pranimi të kandidaturës,

kryetarit të Sindikatës, z. Zeqirit iu dhurua edhe një shenjë me mbishkrimin CESP.

Sindikata e PK-së pas anëtarësimit të plotë pritet të jetë anëtare me të drejta të barabarta krahas të gjitha sindikatave të policive evropiane.

Sindikata e PK-së vazhdon t'i përkrahë dhe t'i mbështesë zyrtarët policorë në aspektin sindikal, përfshirë dhe duke mos i harruar kurrë edhe familjarët e

policëve të rënë në kryerje të detyrës, ku bijtë e tyre dhanë atë më sublimen, dhanë jetën e tyre në shërbim të vendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Ky event sportiv i organizuar nga Sindikata e PK-së u përkrah dhe u mbështet me donacione nga Komuna e Pejës dhe kompani të ndryshme, të cilëve Sindikata e PK-së u është shumë mirënjohëse dhe falënderuese.

Përgatiti: Çajup Kajtazi

Sindikatës së Policisë së Kosovës i është pranuar kandidatura për anëtarësim në CESP Conseil Européen des Syndicats de Police - Këshillit Evropian të Sindikatave të Policisë





POLICIA E KOSOVËS / POLICIJA KOSOVA / KOSOVO POLICE

*Urime festat e fundvitit!
Srečni novogodisnji praznici!
Happy holidays!*